

**Prindërve të nxënësve të klasës
"Raccordement 1"**

Ref. : AP/JV/est

Lozanë, shtator 2020

Zonjë, Zotëri,

Fëmija juaj sapo ka filluar vitin tranzitor "Raccordement 1" dhe së shpejti do t'i duhet të bëjë zgjedhje që do të përcaktojnë të ardhmen e tij.

Për t'ju mbështetur, juve dhe fëmijën, në reflektimin dhe përçapjet që duhet të bëni, keni në dispozicion një **psikolog këshillues në fushën e orientimit**, në entin shkollor. Ai do të kalojë në klasë për të rikujtuar objektivat dhe etapat e rëndësishme të këtij viti tranzitor. Mund të kërkohen edhe takime individuale, në të cilët jeni të mirëpritur.

Ju ftojme që paralelisht të përdorni edhe **mjetet e ndryshme të informimit** të vëna në dispozicionin tuaj për të mbështetur fëmijën në këto përçapje të rëndësishme :

- Seancat "Info-Métiers" (Informim mbi profesionet) (programi në shtojcë)
- Sallonin e profesioneve dhe të formimit që zhvillohet nga 24 deri në 29 nëntor 2020
- Qendrën e informimit mbi studimet dhe profesionet (CIEP) të rajonit tuaj
- Dokumentet që i janë dhënë fëmijës në klasën "VG"
- Sitin e Internetit **www.vd.ch/orientation**
 - ▶ *Pour les élèves de la scolarité obligatoire*
 - ▶ *Télécharger les publications de l'OCOSP*

Me gjithë dëshirë, do të qëndrojmë në dispozicionin tuaj për çdo informacion plotësues.

Duke ju falënderuar për vëmendjen që do të tregoni për sa sipër, na lejoni t'ju drejtojmë, Zonjë, Zotëri, përsëritet tona më të mira.

Shefi i entit shkollor/Shefja e entit shkollor

Shtojca : bashkëlidhur.

Kopje : Mësuesve kujdestarë dhe Drejtorive të enteve shkollore përkatëse.